



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-182
26.02.2026
Shkup

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafët 10¹ dhe 13, neni 24 dhe neni 79, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 15, paragrafi (1) nënparagrafi 2, nenit 41, paragrafi (1), nënparagrafët 8 dhe 11 dhe neni 59, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.ark.01-3632/1 datë 22.8.2025 dhe neni 51, paragrafët (1) dhe (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), duke vepruar sipas Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, nr.ark.01/2026 datë 13.02.2026 (nr.y në PA1 nr.08-182 datë 13.2.2026), në seancën e 8-të mbajtur më 26.2.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-702/5 datë 26.2.2026, miratoi:

VENDIM
për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të
Shoqërisë Tregtare RAdiodifuzive
TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë

1. Leja për transmetim televiziv Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, PA1 nr.08-182 datë 29.3.2017, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, nga 8.3.2026 deri më 7.3.2035.

2. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, në pajtim me pikën numër 1. të këtij Vendimi, do t'i japë leje të re.

3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, për periudhën për të cilën vazhdohet leja, është e detyruar të punojë në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Ligjin për Media, dispozitat e miratuara në bazë të tyre, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

5. Padia nuk e anulon zbatimin e këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Në nenin 79 (Kohëzgjatja e lejes për transmetim televiziv ose radio) paragrafi (1) nga Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele - LShMAAV, është përcaktuar se leja për transmetim televiziv ose radio të Shoqërive Tregtare Radiodifuzive dhe Institucioneve Radiodifuzive Jofitimprurëse i ndahet për periudhë kohore prej nëntë vitesh, duke mundësua vazhdimin e lejes.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

Në pajtim me nenin 79, paragrafi (2) të LShMAAV, leja për kryerje të veprimtarisë radiodifuzive nuk mund t'i bartet një personi tjetër.

Leja për transmetim televiziv ose radio në pajtim me nenin 79, paragrafi (3) të LShMAAV, mund të vazhdohet me kërkesë të zotëruesit për një kohë prej nëntë vitesh. Kërkesa dorëzohet në Agjencion në afat deri në gjashtë muaj para skadimit të vlefshmërisë së lejes. Këshilli Agjencisë detyrimisht miraton vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me të cilën vazhdohet leja, nëse transmetuesi nuk ka kryer shkelje në pajtim me paragrafin (4) të nenit.

Në pajtim me nenin 79, paragrafi (4) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë miraton vendim për refuzim të kërkesës për vazhdimin e lejes nëse transmetuesi ka kryer shkelje serioze gjatë kohëzgjatjes së lejes dhe atë: - së paku tre here gjatë kohëzgjatjes së lejes ka kryer mosrespektim të ndalesave të veçanta të nenit 48 të Ligji, për të cilat ka aktgjyqime të formës së prerë ose – gjatë kohëzgjatjes së lejes, së paku në një cikël zgjedhor mbulimi mediatik nuk është bërë në mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe të paanshme, për të cilat ka aktvendime të formës së prerë.

ShTR TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, është zotërues i Lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-182 datë 29.3.2017, me vlefshmëri prej 9 (nëntë) vitesh, duke filluar nga 8.3.2017 deri më 7.3.2026 për transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar, në nivel rajonal me zonë transmetimi D8 – Kodra e Diellit (komuna Tetovë, komuna Gostivar, komuna Bogovinë, komuna Brvenicë, komuna Vrapçisht, komuna Zhelinë, komuna Jagonovc dhe komuna Tearcë), shërbim programor televiziv me format të specializuar me funksion argëtues, në gjuhën shqipe.

Në ueb faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (AShMA), është publikuar formular i Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim TV/RA dhe shtojca ndaj kërkesës, dhe atë: Dokumenti përkatës si dëshmi se transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie ndalesë për kryerje të veprimtarisë nga regjistri ose evidencë (në origjinal ose kopje të noterizuar dhe jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit), ose deklaratë nga drejtuesi i radiodifuzerit që nuk i është shqiptuar mesë sigurie ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, të noterizuar (dhe jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit); Deklaratë nga transmetuesi, e noterizuar që nuk i respekton karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike e RMV-së (AKE) në pajtim me Ligjin e Komunikimeve Elektronike (LKE) dhe dispozitat e miratuara me ligj; respektimin e kushteve minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio të miratuar nga AShMA; nuk shkelen dispozitat nga Kapitulli IV i LSHMAAV dhe të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha shkresat janë të besueshme dhe të vlefshme, si dhe Pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale të paraqitura në Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim TV/RA.

Më 13.2.2026 ShTR TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, në pajtim me nenin 79, paragrafi (3) të LShMAAV, ka paraqitur Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv, nr.ark.01/2026 datë 13.02.2026 (nr.y në PA1 nr.08-182 datë 13.02.2026) në formularin përkatës. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, u konstatua se kërkesa është e rregullt dhe e plotë dhe i përmban të gjitha shtojcat e nevojshme, dhe atë: Deklaratë nga Vigan Ibishi e dhënë në cilësinë e themeluesi të vetëm/pronar dhe në cilësinë e drejtuesit të radiodifuzerit ShTR TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, se transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie ndalesë për kryerje të veprimtarisë, (e noterizuar, jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit) – nr.UZP 1615/2026 datë 13.2.2026, Deklaratë nga Vigan Ibishi e dhënë në cilësinë e themeluesi të vetëm/pronar dhe në cilësinë e drejtuesit (e noterizuar) nr.UZP 1614/2026 datë 13.2.2026, që ShTR TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë do t'i respektojë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga AKE në pajtim me LKE dhe dispozitat miratuar në bazë të ligjit; do t'i respektojë kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio të miratuar nga AShMA; nuk shkelen dispozitat nga Kapitulli IV të LSHMAAV dhe se të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha shtojcat janë të besueshme dhe të vlefshme, si dhe Pëlqim për përpunimin e të dhënave personale të cekura në Kërkesë, të dhëna nga drejtuesi i radiodifuzerit.

Nga AShMA u konstatua se gjatë kohëzgjatjes së lejes, kërkuesi - ShTR TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, i përmbush kushtet e përcaktuara të nenit 79 të LShMAAV,

përkatësisht nuk ka kryer shkelje serioze të përcaktuara në nenin 79, paragrafi (4) të LShMAAV.

Duke marrë parasysh sa më sipër, mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga drejtori i AShMA-së, në pajtim me Autorizimin, nr.ark.03-5648/1 datë 29.12.2025, drejtuar Këshillit të AShMA-së dorëzoi Propozimin, PA1 nr.08-182 datë 24.2.2026, për miratim të vendimit për vazhdim të Lejes për transmetim televiziv të ShTR TOPESTRADA SHPKNJ P Tetovë, PA1 nr.08-182 datë 29.3.2017, vlefshmëria e të cilit prej nëntë vitesh skadon më 7.3.2026, dhe e njëjta të vazhdohet për kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vitesh, përkatësisht nga 8.3.2026 deri më 7.3.2035.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, neni 20, paragrafi (1) nënparagrafët 10 dhe 13, neni 24 nga LSHMAAV dhe neni 79 nga Ligji i njëjtë, në pajtim me nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafët 8 dhe 11 dhe neni 59, paragrafi (1), (2) dhe (3) të Rregullores së Punës së AShMA-së dhe neni 51, paragrafët (1) dhe (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, duke vepruar sipas Kërkesës nr.ark.01/2026 datë 13.02.2026 (nr.ynë.PA1 nr.08-182 datë 13.02.2026) për vazhdim të lejes për transmetim televiziv të ShTR TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, Këshilli i AShMA-së miratoi Vendim si në dispozitiv, ky vendim është përfundimtar dhe pas miratimit do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb faqen e AShMA-së. ShTR TOPESTRADA ShPKNJ P Tetovë, për vazhdimin e lejes nga pika numër 1. të këtij Vendimi, AshMA do t'i japë leje të re. Transmetuesi është i detyruar për periudhën për të cilën vazhdohet leja të punojë në pajtim me LShMAAV, LM, dispozitat e miratuar në bazë të ligjit, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje. Padia nuk anulon zbatimin e Vendimit.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi nga pika 1. të këtij vendimi, ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.